



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Më
Dana

27 - 03 - 2018

P.nr.262/2015

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër [REDAKTUAR] nga Ferizaji rruga magjistrale Ferizaj-Prishtinë, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.923-4/14 të dt.23.02.2015, sipas së cilës e ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 par.1 të KPK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.15.06.2015 solli

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.923-4/14 të dt.23.02.2015, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] nga Ferizaji rruga magjistrale Ferizaj-Prishtinë, nga i ati [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike me numër të Inj. [REDAKTUAR] mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës 10.02.2014 deri me datën 13.02.2014, në shtëpinë e tij në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë, në njesorin e tij elektrik me nr.92306684 i ka dëmtuar vulat zyrtare-bllombat me nr.R7006134 të cilët e kanë venë punëtorët të autorizuar të KEDS-it Distrikti Ferizaj, pas disa dite është shkrytur përsëri nga rrjeti elektrik dhe është pllombuar me bllomben me nr.R7006186 me qëllim të sigurimit të njësorit elektrik pronë e të pandehurit, kështu që ka dëmtuar pllombat dhe është rikrytur paautorizim në rrjetin elektrik,-

- me të cilën kreu veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga nen.414 par.1 të KPK-së .

- Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

E dëmtuara KEDS- Distrikti në Ferizaj nuk e ka precizuar dëmin që i ka shkaktuar i akuzuari gjykata për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të gjitha nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.923-4/14 të dt.23.02.2015, ka akuzuar [REDAKTUAR] nga Ferizaji rruga magjistrale Ferizaj-Prishtinë, me të cilën krën veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga nen.414 par.1 të KPK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 414 par.1 të KPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjyqtari ka lexuar kallximin penal të KEDS-it-Distrikti në Ferizaj me nr.CMS-K/DFE-465/14 e dt.03.04.2014 procesverbalin me nr.0977134 të datës 13.02.2014 dhe procesverbalin me nr.0983464 i dt.10.02.2014 dhe ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.1 të KPPK-së e dëmtuara KEDS- Distrikti në Ferizaj për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ **P.nr.238/2015 me dt.15.06.2015**

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.